



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 851, date 7.12.2016

PËR

**KALIMIN E TË DHËNAVE MBI SHTRIRJEN E RRJETIT TË
INFRASTRUKTURËS INXHINIERIKE TE BASHKITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të dhënat mbi shtrirjen dhe kapacitetin e rrjeteve e të linjave të infrastrukturave inxhinierike ekzistuese në zonë përbëjnë informacion publik dhe u jepen palëve të interesuara nga bashkia përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Ngarkohen institucionet përgjegjëse për infrastrukturën rrugore, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, OSHEE, sh.a-ja., OST, sh.a-ja., si dhe shoqëri të tjera që operojnë në fushën e ujësjellës - kanalizimeve dhe rrjeteve elektrike, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të dorëzojnë pranë bashkive përgjegjëse të gjitha të dhënat dhe materialin e përditësuar hartografik mbi shtrirjen dhe kapacitetin e rrjeteve e të linjave infrastrukture si dhe të njoftojnë bashkitë për çdo ndryshim të këtyre rrjeteve në vijimësi. Për dhënien e informacionit të sipërpërmendur nuk aplikohet tarifë.
3. Të dhënat për rrjetet e telekomunikacionit merren nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i cili u siguron bashkive akses në sistemin e përqendruar të informacionit për rrjetet e komunikimeve

elektronike, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Dhënia e informacionit mbi shtrirjen dhe kapacitetin e rrjeteve e të linjave të infrastrukturave inxhinierike ekzistuese si dhe mbi pikat e lidhjes me këtë rrjet është pa pagesë.
5. Deri në kalimin e të dhënave, sipas pikës 2, të këtij vendimi, operatorët e shërbimeve publike kanë detyrimin t'u japin bashkive të dhënat dhe konfirmimet e nevojshme mbi rrjetet përkatëse, përfshirë përmes sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe subjektet juridike të përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA